

1. Ku prodhohen Kepo kaldajat?

Kepo kaldajat janë prodhim vendor, të prodhuara në firmën Kapo nga Kosjeriq. Kaldajat punohen prej teneqes për kaldaja me trashësi 3-5mm, që prodhohet në 'Železara Smederevo', e pajset përcjellëse janë nga Italia, Britania e Madhe dhe Zvicra.

2. A ka nevojë për pajisje shtesë që kaldaja të funksionojë?

Kaldaja në vete i përmban të gjitha elementet të cilat janë të domosdoshme për montim në sistemin e ngrohjes qendrore: valvula për mbushje dhe zbrazje, valvulën siguresë, enën shpërndarëse dhe pompën e ujitë. Nëse garancin 2 vjeçare dëshironi ta rritni në 5 vjet, atëherë duhet të montohet valvula përzierëse me termo kokë 40°-70°C dhe në këtë mënyrë siguron jetëgjatësi punuese më të madhe për kaldajën. Me kalda duhet blerë edhe qyngat të atestuara për kaldaja dhe stufa me pelet. dhe me to të bëni lidhjen mes kaldajës dhe oxhakut.

3. Sa është kaldaja e sigurtë për shfrytëzim?

Kaldaja posedon mbrojtje të shumëfishtë nga tejnxeja. Shkallën e pare të mbrojtjes e bënë elektronika, e cila nuk e lejon temperaturën e ujitë të ngritet mbi 85°C, e shkalla e dytë e mbrojtjes është termostati siguresë, që ndërprejnë dozimin e peletit kur kaldaja e arrinë temperaturën kritike. Termostati nuk e lejon tejnxejen e kaldajës, por e lajmëton gabimin dhe e fikë kaldajën.

Elektronika nuk lejon që presioni në sistem të jetë më i madh se 2,5 bar, si dhe më të ulët se 0,6 bar. Në të dyja rastet e lajmëron gabimin dhe e fikë kaldajën.

Në rast se për ndonjë arsye elektronika dështon, kaldaja posedon valvulën siguresë e cila lëshon ujinë prej sistemit në 3 bar dhe me këtë e liron presionin.

Kaldaja posedon edhe vakumin siguresë të presuar, roli i të cilit është nëse rastësisht vjen deri tek mbyllja e qyngës, si dhe qarkullimit të dobët të gazrave tymues përmes qyngës, e ndërprejnë dozimin e peletit dhe parandalon çdo lloj mundësie të depërtimit të tymit jasht kaldajës, e lajmëron defektin dhe e fikë kaldajën.

Kaldaja ka edhe valvulën mekanike, roli i të cilës është që në rast të presionit të madh në furrën për djegie, të ulet shtypja dhe në këtë mënyrë të parandaloj çdo lloj problem në funksionimin e tutjeshëm të kaldajës.

4. Çfarë lloj kaldajash keni në ofertë?


Kepo në ofertën e vet ka dy seri kaldajsh, **AC** (me pastrim automatik të ndezësit) dhe **MC** (me pastrim manual të ndezësit), prej 15, 20, 25 dhe 35kw.

5. A është i nevojshëm qarkullimi i ajërit të freskët për punën e kaldajës?

Kepo kaldaja është shpenzues i madh i oksigjenit, kështu që është e nevojshme të sigurohet qarkullim të mjaftueshëm të ajërit të freskët.

Në ngrohtore është e domosdoshme të ndërtohet vrima me madhësi, së paku, 100cm², në pjesën e poshtme të ngrohtores(hapësirës ku qëndron kaldaja).

E dëshirueshme është të bëhet edhe vrima ventiluese në pjesën e epërme të ngrohtores.



6. A më nevojitet oxhaku?

Është e domosdoshme që kaldaja të jetë elidhur me qyngën e izoluar, gjatësia minimale 3m dhe perimetri minimal të jetë Ø130mm.

Kepo në programin e saj prodhues ka edhe qynga inox të izoluar montazh, kështu që mund të na kontaktoni për informata më të detajuara.

Kurrsesi nuk guxon të përcillni tymin nëpër qyngat e paizoluara nga ana e jashtme e murit apo jasht hapësirës së paizoluar, Në këtë mënyrë do të shkaktoni kondenzim dhe të pengoni punën e kaldajës dhe qyngës.

7. Kaldaja a e ka mundësinë e punës automatike?

Po, kaldaja e mundësinë e punës automatike të cilën mund ta rregulloni në dy mënyra, përmes vetë pajisjes automatike në kaldajë apo përmes termostatit të dhomës.

8. Sa është volumi i tankut të peletit?

- AC/MC 15 - 40kg
- AC/MC 20 - 62kg
- AC/MC 25 - 75kg
- AC/MC 35 - 120kg

9. Në çfarë intervali kohorë pastrohet kaldaja?

Pastrimi i kaldajës mund të jetë i rregullët dhe general, e intervli varon varsisht nga shpenzimi. Pastrimi i rregullët është në intervalin nga 3 deri në 7 ditë, e ai gjeneral një herë në vit. Mirëmbajtja e kaldajës ndikon në shpenzimin e peletit dhe efikasitetin e funksionimit.

10. Sa është i rëndësishëm kualiteti i peletit për punë efikase të kaldajës?

Ky është një prej faktorëve kryesor për punën efikase të kaldajës.

Varësisht nga kushtet në teren, rregullohen parametrat dhe kaldaja e fillon funksionimin. Kur parametrat harmonizohen me oxhakun tuaj dhe qarkullimin e oksigjenit, tjetra që varet për punën efikase të kaldajës është peleti.

Peleti kualitativ kurrë nuk ka qenë aq i shtrenjët! Duke shfrytëzuar pelet kualitativ do t'i shmangeni:

- ardhjes së shpeshtë dhe shpenzimet e serviserit
- fikjes së pavarur të kaldajës për shkak të djegies së dobët në shpuzore
- shtresës së madhe të hirit në kanalet tymëpërcjellëse dhe pastrimit më të shpesh të kaldajës sesa është e caktuar
- shpenzim më i madh i peletit

Kaldaja me pelet punon në parimin e djegies së kontrolluar, dhe me vetë këtë peleti duhet të jetë i kualitetit të mirë, për të qenë në gjendje kaldaja të funksionojë papengesa dhe kursyeshëm.